



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Keqklasifikimi i shpenzimeve në shumën 252,910€ si pasojë e mos regjistrimit të duhur të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike përkatëse.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Rahovecit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit.
 - A3 Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve.
 - B1 Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare.
 - B2 Zotimi i mjeteve për 39 pagesa është bërë jo sipas rregullave financiare.
 - B3 Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor.
 - C1 Pagesa shtesë +30%, në mungesë të shtimit të numrit të të angazhuarve për 30%.
 - B4 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.
- Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Rahovecit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Rahovecit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Rahovecit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë,

por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Rahovecit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Rahovecit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Procesi i raportimit në Komunë është përcjellur me mangësi, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Më tutje, pasqyrat financiare janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA, përveç çështjeve të trajtuara më poshtë të cilat kanë ndikuar në opinion e auditimit.

Në mungesë të kontrolleve të brendshme të duhura në Komunë, janë identifikuar disa çështje të cilat kanë ndikuar te opinionin e auditimit dhe konkluzioni i pajtueshmërisë.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Neni 18, paragrafi 3, i Rregullores Financiare nr. 01/2013/MF, "Mbi shpenzimet e parasë publike", përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet ekonomike adekuate sipas Udhëzimit Administrativ për planin kontabël.

Bazuar në testet e kryera rezulton se, kishte raste të klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim:

- Shpenzimet për projektin "Ndërtimi dhe furnizimi me material ndërtimor për familjet skamnor", në shumën 37,163€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve;

- Shpenzimet për projektin "Ndërtimi i serave me participim", në shumën 100,000€; 41,727€; dhe 34,020€ përkatësisht, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të regjistrohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve; dhe

- Shpenzimet në emër të bashkëfinancimit në bujqësi me fermerët e Komunës, në shumën 40,000€, ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale në vend që të klasifikohen në kategorinë subvencioneve dhe transfereve.

Keqklasifikimet kanë ndodhur për shkak të planifikimit dhe buxhetimit jo

adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

Ndikimi

Klasifikimet ekonomike jo të sakta prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve të pasqyrave financiare, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, si dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë, që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planfikohen në ndarjet/ kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit

Gjetja	Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 32.1, për një aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurën e hapur ose procedurën e kufizuar. Nëse një dispozitë e neneve 34-37 të këtij ligji shprehimisht autorizon shfrytëzimin e një procedure tjetër prokurimi, autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë atë procedurë ose procedurën e hapur. Ushtrimi i një procedurë të prokurimit duhet të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme të këtij ligji. Kontrata "Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhienike e objekteve të komunës së Rahovecit", me vlerë 50,000€, është kontraktuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me ftesë të një operatori ekonomik duke u thirrur në nenin 35 paragrafin 2.1 të LPP-së, ndërsa do të duhej të realizohet përmes procesit të rregullt të prokurimit më procedurë të hapur. Sipas zyrtarëve të Komunës kjo ka ndodhur si pasojë e vonesës në iniciimin e aktivitetit të rregullt të prokurimit.
Ndikimi	Përdorimi i procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë, lë hapsirë të kufizimit të konkurrencës në rastet kur shërbimin mund ta ofertojnë shumë operator ekonomik.
Rekomandimi A2	Kryetari duhet të sigurojë, që iniciimi i aktiviteteteve të prokurimit bëhet në kohë dhe përdorim të duhur të procedurave të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve

Gjetja	Komuna kishte bërë thirrje publike për subvencionim të sportit, në të cilën janë përcaktuar kriteret që duhet t'i plotësojnë përfituesit e subvencioneve. Një ndër kriteret e përcaktuara në thirrjen publike ishte, që aplikuesit të ofrojnë vërtetimin tatimor si dëshmi që nuk ka obligime tatimore ndaj Administratës Tatimore. Bazuar në testet e kryera rezulton se, tre OJQ-të fituese të subvencioneve janë përzgjedhur pa i plotësuar dokumentacionet e kërkuara në thirrjen publike, të cilat kishin dorëzuar vërtetime jo valide, si dëshmi për shlyerjen e borxheve ndaj ATK-së. Dokumentet në fjalë nuk kishin rezultuar nga sistemi i ATK-së. Shumat vjetore të këtyre tre përfituesve të subvencioneve në total janë 72,600€. Sipas zyrtarëve të Komunës kjo kishte ndodhur, sepse komisioni për vlerësim të dokumenteve të aplikuesve për përfituesit e subvencioneve të sportit, nuk kishte vërtetuar vlefshmërinë e vërtetimit tatimor.
Ndikimi	Përzgjedhja e përfituesve nga Komisioni vlerësues, pa u përmbushur

kriteret e parapara në thirrjen publike, paraqet dëmtim të buxhetit dhe jo transparencë publike.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë, që Komisioni për vlerësim të aplikacioneve dhe përzgjedhje të përfituesve të subvencioneve të sportit, të zbatojë të gjitha kriteret e parapara në thirrjen publike dhe në asnjë rast mos të tejkalohet pa u vërtetuar se dëshmitë janë valide me theks të veçantë të vërtetimit për shlyerjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare

Gjetja Neni 13.8, i Ligjit nr. 07/L-41 për ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2021, parasheh që nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizatat buxhetore, vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara me ligjin e buxhetit për vitin aktual dhe për dy vite në vijim.

Në dy raste ishin nënshkruar kontrata për projekte kapitale deri sa nuk kanë pasur mbulueshmëri financiare si:

- Për projektin "Ndërtimi i AMF-së në lagjën e epërme", me ligjin e buxhetit aktual dhe dy vitet pasuese ishin paraparë 150,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 252,269€ apo 102,269€ më e lartë se vlera e planifikuar; dhe

- Për projektin "Ndërtimi i kanalit të kullimit tokave në Fortesë-Celinë", me ligjin e buxhetit për vitin aktual dhe dy vitet pasuese janë paraparë 220,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 239,520€, apo 19,520€ më e lartë se vlera e planifikuar.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, dhe nënshkrimi i kontratave për tej limiteve buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të Komunës duke qenë se duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve. Kjo pamundëson realizimin e projekteve tjera të parapara të realizohen nga mjetet e ri destinuara.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale në rastet kur shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim, apo mundësisë së ridestinitimit të mjeteve për projektet kapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, në nenin 12, përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër- blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa.

Bazuar në testet e kryera rezulton se, për 39 pagesa me vlerë 2,032,699€, fillimisht ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.

Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme ndikon në krijimin e obligimeve të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi, sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/ shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor.**

Gjetja Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, në nenin 39.1, parasheh që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve, kemi vërejtur se gjatë vitit 2021 ishin kryer pagesa në shumën 2,523,472€ apo 1,165 raste të pagesave nga lista e furnitorëve, të cilët e kishin tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohor ligjor, që kanë rezultuar dhe mund të ndikoj njëherit në shtimin e numrit të realizimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.

Ndikimi Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e Komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, Komuna mund të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbarimore.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave, për të siguruar që Komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Pagesa shtesë +30%, në mungesë të shtimit të pozicionit/ artikullit**Gjetja**

Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, në nenin 56.10, ndër të tjera përcakton mospërputhjet e lejuara në rastin e Kontratave Publike Kornizë, që janë +/- 30% edhe për pozicione apo artikull.

Kontrata kornizë "Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit – shtretër shtëpiak", në shumën 378,000€, parasheh angazhimin e 53 punonjësve për realizimin e këtij projekti. Përveç kësaj, Kontrata përmban edhe +/- 30% si devijim të lejuar të shumës së Kontratës.

Për tre pagesa të testuara për muajt prill, qershor dhe gusht pagesat e faturave përmbledhëse për secilin muaj ishin 20,475€, shumë kjo e cila përmbanë + 30% e lejuar shtesë për muaj. Por, shtesa e lejuar financiare nënkupton edhe shtimin e pozicionit ose artikullit, e që në rastin konkret është numri i punonjësve nga 53 në 69 punonjës.

Mirëpo, sipas raporteve të pranimit nga lista e të angazhuarve të hartuara nga Komisioni i pranimit, shihet se krahas shtimit të vlerës financiare nuk është bërë edhe rritja e numrit të punonjësve:

- Për muajin prill janë angazhuar 61 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe tetë punonjës (katër mjekë dhe katër infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,420€;

- Për muajin qershor janë angazhuar 62 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe shtatë punonjës (katër mjekë dhe tre infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,200€;

- Për muajin gusht janë angazhuar 61 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe tetë punonjës (katër mjekë dhe katër infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,420€.

Për shkak të mosfunksionit adekuat të kontrolleve, faturimi ishte bërë në formë të përmbledhur pa u bashkangjitur specifikimet e pozicioneve të kontraktuara.

Ndikimi

Pagesa dhe faturimi përmbledhës pa ju bashkangjitur specifikacioni i pozicioneve të kryera, rritë rrezikun e pagesave për punë/ shërbime të pa kryera dhe njëherësh ndikon në dëmtimin e buxhetit.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë**Gjetja**

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohej zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:

Për 735 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 – “Zbritjet për vendbanim parësor”, mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 16,537€.

Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake, mirëpo për faturimet e vitit 2022, për tatimpaguesit që nuk kanë numër personal të evidentuar dhe të cilët nuk e kanë deklaruar “Banimin Parësor” nuk do të zbatohet zbritja e lejuar.

Ndikimi

Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim më të mirë në mes të tatimpaguesve, departamentit të Tatimit në Pronë-Komunës dhe departamentit të Tatimit në Pronë-Ministritë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara ishin në vlerë 1,174,111€ apo 11% më të larta se plani vjetor. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç kësaj, Komuna kishte edhe të hyra indirekte në shumë prej 325,234€ që kanë të bëjnë me të hyrat nga dënimet në trafik, dënimeve nga gjykatat dhe ato të agjencionit të pyjeve.

Çështja B5 - Ankesa lidhur me vlerësimin jo të duhur të pronave

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, në nenin 12 paragrafi 2, përcakton se çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që brenda territorit të komunës. Sipas këtij paragrafi ndër përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim: regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme; shqyrton dhe vendos mbi ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme.

Pas analizës së bërë, në lidhje me trajtimin e ankesave për vlerësim jo të duhur të pronave, janë identifikuar mangësitë si në vijim:

Përkundër përpjekjeve, Komuna nuk kishte arritur të ketë një bashkëpunim të duhur sa i përket azhurnimit të informatave në bazën e të dhënave të Tatimit në Pronë dhe vlerësimit të pronave. Në Komunë kishin pranuar 129 ankesa në lidhje me vlerësimin jo të duhur të pronave (88 ankesa për prona banimi, 28 për prona komerciale dhe gjashtë për parcela). Nga 129 ankesa, vetëm 13 janë refuzuar kurse 116 ankesa tjera janë pranuar si të bazuara, nga të cilat kishte rrjedhur një korrigjim në vlerësim të pronave në shumën totale 11,670€. Ky fakt tregon për nivelin e lartë të gabimeve në bazën e të dhënave të tatimit në pronë.

Vlerësimi jo i duhur i pronave, kishte ndodhur për shkak të komunikimit të pamjaftueshëm ndërmjet Komunës dhe Ministrisë së Financave, si dhe për shkak të stafit të limituar në zyrën e Tatimit në pronë.

Ndikimi

Mos azhurnimi i informatave dhe vlerësimi jo i duhur i pronave në bazën e të dhënave të tatimit në pronë mund të vështirësoj inkasimin e të hyrave si dhe ndikon në rritjen e të arkëtueshmeve si pasojë e paknaqësive të qytetarëve.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari të sigurojë rritjen e kontroleve në mënyrë që të bëhet vlerësimi i saktë i pronave të tatimpaguesve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,159,358€, prej tyre ishin shpenzuar 4,961,170€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, mirëmbajtjen të lumenjve, objektet arsimore, pajisje tjera etj.

Çështja B6 - Vonesa në realizimin e projekteve

Gjetja

Ligji i Prokurimit Publik, në nenin 81, por edhe tek Rregullat dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik, parashohin që menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Për projektet si në vijim, nuk ishin realizuar punimet sipas planit dinamik, siç parashihej me kontratë, pra kishte vonesa të konsiderueshme në procesin fizik të tyre:

- "Ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijve në fashatin Ratkoc", kontrata e nënshkruar më 20 nëntor 2018 në shumën 468,298€, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 67%;

- "Rregullimi i shtretërve të lumenjve", kontrata e nënshkruar më 6 dhjetor 2018 në shumën 765,095€, do të duhej të përfundonte brenda tre viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 61%;

- "Ndërtimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit", kontrata e nënshkruar më 3 dhjetor 2018 në shumën 441,155€, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 90%;

- "Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit", kontrata e nënshkruar më 3 dhjetor 2018 në shumën 271,188€, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 92%.

Sipas zyrtarëve të Komunës, vonesat në realizimin e këtyre projekteve, kanë ndodhur si rezultat ose i mos marrëveshjeve me pronarët e tokave, ose për shkak të buxhetimit jo të duhur për projekte të caktuara. Megjithatë, kjo tregon se Komuna nuk ka kontrollë efektive me rastin e monitorimit në realizimin e projekteve.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që Komuna të mos arrij objektivat e përcaktuara dhe në mungesë të fondeve buxhetore për vitet pasuese, projektet e filluara mund të mos përfundohen edhe një kohë.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë që, paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave të realizimit të projekteve si ato pronësore, si dhe të sigurojë se projektet kapitale buxhetohen me fonde të mjaftueshme për to, me qëllim të realizimit të projekteve sipas planit kohor dinamik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës**Gjetja**

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimit Publik, neni 30 përcakton se, "Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës".

Për dy projekte në vijim, zyra e prokurimit nuk e kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, krahas vazhdimin të realizimit të kontratave të cilat ende nuk kanë përfunduar si:

- Për projektin "Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Ratkoc", me vlerë të kontratës 46,292€, siguria e ekzekutimit të kontratës kishte validitet deri më datën 16.11.2019 ndërsa përfundimi i punëve sipas kontratës ishte paraparë më datën 20.11.2020, dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri në kohën e kryerjes së auditimit; dhe
- Për projektin "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe proçkave", me vlerë të kontratës 765,095€, siguria e ekzekutimit të kontratës kishte validitet deri më datën 4.12.2020 ndërsa përfundimi i punëve sipas kontratës ishte paraparë më datën 06.12.2021 dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri në kohën e kryerjes së auditimit.

Shkaku i një dukurie të tillë, ishin vonesat në realizimin e kontratave përkatësisht mungesa e komunikimit, në mes të menaxherëve të kontratave dhe zyrës së Prokurimit.

Ndikimi

Mungesa e sigurisë së ekzekutimit përveç që është anashkalim ligjor, rritë rrezikun që autoriteti kontraktues, të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale të mundshme që mund të rrjedhin gjatë periudhës së shtyrë për implementimin e këtyre kontratave.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C2 - Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese****Gjetja**

Sipas nenit 81 të LPP, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të përgatisin planin për menaxhim të kontratës. Plani i Menaxhimit të Kontratës (më tutje PMK) është dokument i cili do të përditësohet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Plani i menaxhimit të kontratave nuk ishte nënshkruar nga palët kontraktuese për projektet:

"Ndërtimi i AMF-se në lagjen e epërme"; "Renovimi i objektit të

vjetër të QKMF-së në Rahovec”;

“Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore”;

“Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit” faza e dytë Lot 1; dhe

“Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit” faza e dytë Lot 2.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk e kishte vlerësuar të nevojshme nënshkrimin pasi ato plotësohen sipas tyre në sistem.

Ndikimi

Mos plotësimi me informatat, përkatësisht mos nënshkrimi i këtij dokumenti nga menaxheri i kontratës dhe pala kontraktuese, sipas kërkesave të LPP mund të rezultojë në mos përmbushjen e kontratës sipas rregullave të përcaktuara me kontratë.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët projekteve të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese me qëllim të përmbushjes së detyrave kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e prezantuar në PFV e pasurive kapitale është 136,258,978€, pasurive jokapitale është 837,206, si dhe e stoqeve 133,349€.

Çështja B7 - Mangësi në regjistrimin e pasurisë

Gjetja Rregulorja nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, në nenin 6, përcakton që, "Pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria."

Sipas rishikimit të regjistrimit të përgjithshëm të pasurive, kemi vërejtur se katër pagesa në shumë prej 72,223€ (pasuri kapitale mbi 1000€) nuk ishin regjistruar në SIMFK, si dhe katër pagesa (pasuri nën 1000€) në shumë prej 20,786€, nuk ishin regjistruar në e-pasuria. Përveç kësaj, për pasuritë nën 1000€ nuk ishte llogaritur zhvlerësimi vjetor.

Sipas zyrtarit të pasurisë, mos regjistrimi i katër pagesave mbi dhe nën 1000€ ka ndodhur si rezultat i defektit në softuerin e Komunës dhe si rezultat i kësaj kanë mbetur të pa regjistruara. Po ashtu, mos llogaritja e zhvlerësimit për pasuritë nën 1000€ ka ndodhur për shkak të skadimit të kontratës së softuerit e-pasuria.

Ndikimi Mos regjistrimi i plotë i pasurive mbi dhe nën 1000€ dhe mos llogaritja e zhvlerësimit vjetor të pasurive ndikon në prezantimin jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë se do të regjistrohen të gjitha pasuritë mbi dhe nën 1000€ në suftueret perkatëse, në mënyrë që vlera e pasurive të prezantohet e plotë dhe e saktë në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Llogaritë e Arkëtueshme (LLA) janë prezantuar në PFV në vlerë prej 2,234,800€. Kjo vlerë përbehet nga tatami në pronë, tatimi në tokë, taksa e biznesit, shfrytëzimi i pronës publike etj.

Çështja B8 - Menaxhimi jo i duhur i të arkëtueshmeve

Gjetja

Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, në nenin 16 përcakton se, Organizata Buxhetore duhet të raportoj Llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Bazuar në testet e kryera, për të arkëtueshmet nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë rezulton se, në katër raste shuma e prezantuar në listën e të arkëtueshmeve nuk përputhet me kartelën financiare të biznesit që dëshmon për borxhin e prezantuar. Kjo mospëputhje është për shumën 20,569€, e cila kishte rrjedhur si pasojë e një gabimi teknik me rastin e hartimit të listës së të arkëtueshmeve.

Për më tepër, pas analizës së të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë, vijm në përfundim se një pjesë e borxheve të grumbulluara, në shumën 275,256€, i përkasin ish ndërmarrjeve shoqërore, të privatizuara gjatë procesit të privatizimit.

Përveç kësaj, Komuna përballet me vlera të larta të të arkëtueshmeve të cilta janë duke u rritur nga viti në vit.

Përpos aplikimit të vërejtjeve ndaj obliguesve si masë e përdorur nga Komuna, kanë munguar veprime të vazhdueshme si iniciimi i procedurave për arkëtim të detyrueshëm të borxheve, nëpërmjet organeve tjera kompetente.

Ndikimi

Mos harmonizimi ndërmjet të dhënave financiare dhe listës së të arkëtueshmeve ndikon në mos raportim të drejtë dhe të saktë të tyre. Ndërsa vjetërsia e të arkëtueshmeve zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që këto llogari të arkëtohen.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë, se janë ndërmarrë veprimet adekuate për një zgjidhje të përbashkët me Agjencionin Kosovar të Privatizimit lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe ish ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e të arkëtueshmeve nga të gjithë pronarët e pronave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,216,590	15,245,214	15,041,586	15,129,427	14,688,602
Grante Qeveritare – Buxheti	13,155,497	13,240,421	13,193,192	13,743,871	13,192,922
Financimi përmes huamarrjes	0	47,052	46,852	100,020	92,191
Të bartura nga viti i kaluar	0	484,781	452,593	309,043	376,714
Të hyrat vetanake	1,061,093	1,061,093	937,785	974,370	961,842
Donacionet vendore	0	4,784	4,177	2,123	652
Donacionet e jashtme	0	407,084	406,988	0	64,280

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,028,624€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të buxhetit, të hyrave të bartura nga viti paraprak, rritjes së grantit qeveritar, donacioneve vendore dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar 99% të buxhetit final ose 15,041,586€, me realizim po thuajse të njëjtë me vitin e kaluar (2020 – 98%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,216,590	15,245,214	15,041,586	15,129,427	14,688,602
Pagat dhe mëditjet	7,622,634	7,602,730	7,602,730	7,716,523	7,330,406
Mallrat dhe shërbimet	1,715,477	1,725,627	1,721,164	1,664,862	1,352,072
Komunalitë	280,500	280,500	280,322	263,830	246,469
Subvencionet dhe transferet	311,000	477,000	476,200	320,532	1,216,728
Investimet Kapitale	4,021,979	5,159,358	4,961,170	5,163,679	4,542,926

Rezervat	265,000	0	0	0	0
----------	---------	---	---	---	---

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar është ulur për (19,904€) për shkak të mos alokimit nga Thesari. Pavarësisht kësaj, janë shpenzuar edhe 8,308€ si pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 10,150€, në bazë të rishikimit të buxhetit;
- Buxheti fillestar me buxhetin final për kategorinë komunalive nuk ka pasur ndryshim, ndërsa të kategoritë e subvencioneve është rritur për 166,000€ si rezultat nga grandin qeveritar me vendim të qeverisë Nr. 11/30 të datës 14.09.2020 për mbështetjen e komunave për menaxhimin e situatës së krijuar nga situata e reshjeve atmosferike ku janë ndarë mjete për kompensimin e dëmeve në amvisëri dhe ekonomi familjare në vlerë prej 151,000€, si dhe 15,000€ janë transferuar nga kategoria Mallra dhe Shërbime në kategorinë subvencione dhe transfere me ri-destinim.
- Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për 1,137,379€, Kjo rritje është rezultat me rishikimin të projekteve kapitale, si dhe po ashtu janë bartur nga kategoria e Rezervës në shumën prej 265,000€ me vendim të Kuvendit Komunal të datës 29.04.2021. Po ashtu vlen të potencohet se kemi një shpenzim efektiv prej 96% të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit. Pavarësisht kësaj, programi i Investimeve Publike përfshin 82 prej tyre 70 projekte të bartura nga vitet e kaluara, gjashtë projekte të reja, tre projekte me grand të performances dhe tre projekte rezervë; dhe
- Si rezultat i situatës pandemike me COVID-19, Komuna e Rahovecit kishte shpenzuar 247,908€, prej të cilave janë paguar për paga dhe mëditje për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë me vendim të qeverisë nr. 08/65 e datës 18.02.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr.07/I-001.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2021 ishin në vlerë 1,174,111€. Ato kanë të bëjnë me: Të hyrat tatimore në shumë prej 577,233€, të hyrat jo tatimore në shumë prej 595,406€, dhe të hyrat nga tjera në shumë prej 1,472€. Përveç këtyre, Komuna ka pasur edhe të hyra indirekte në shumë prej 325,234€ që kanë të bëjnë me të hyrat nga dënimet në trafik, dënimeve nga gjykata dhe ato të agjensionit të pyjeve.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,061,093	1,061,093	1,174,111	1,182,723	1,103,403
Të hyrat tatimore	499,593	499,593	577,233	456,977	459,286
Të hyrat jo tatimore	561,500	561,500	595,406	725,746	644,117
Të hyrat tjera	0	0	1,472		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të komunes së Rahovecit ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Përveç kësaj, Raporti i auditimit ishte shqyrtuar edhe në Kuvendin Komunal, në mbledhjen e mbajtur 30 korrik 2021.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy rekomandime janë zbatuar; dy ishin në proces dhe tetë nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.	Nuk janë ndërmarrë veprimet të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të	Komisioni për pranim të angazhimit të	Pjesërisht i zbatuar

		kontraktuara. Për secilin muaj duhet të hartohen raporte detale për secilin shërbim të ofruar dhe pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria se shërbimet janë pranuar.	punonjësve ka përgatitur raporte për numrin e të angazhuarve për këtë projekt. Por, nuk është rishikuar kontrata se duke implementuar sipas specifikave.	
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj bashkëpunim më të mirë në mes të tatim-paguesve, departamentit të Tatimit në Pronë-Komunës dhe departamentit të Tatimit në Pronë-Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonësve, të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.	Nuk janë ndërmarrë veprimet të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një kordinim më të mirë ndërmjet Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.	Nuk janë ndërmarrë veprimet të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Nuk janë ndërmarrë veprimet të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se menaxheri i kontratës monitoron punën dhe harton raporte lidhur me ecurinë e punës për secilin situacion të pranuar me qëllim të evidentimit të dobësive në proces dhe evitimit të pagesave për punët e papërfunduara. Te siguroj se menaxheret projekteve mund të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës përmban informata të sakta duke prezentuar gjendjen e vertet në kohën e duhur.	Janë emëruar menaxheret e kontratave, mirëpo edhe më tutje nuk ka monitorim në mënyrë adekuate.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen	Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur rastet të tilla.	I zbatuar

		jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP komfor kërkesave ligjore.		
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet në të gjitha dikasteret dhe që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuara, të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PFV për 2021, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet e plot dhe e saktë dhe të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë.	Komuna përkundër progresit të arritur në regjistrimin e pasurive, ende duhet bërë punë në regjistrimin e plotë të pasurive kapitale dhe jo kapitale	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.	Nuk janë ndërmarrë veprimet të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani vjetor i auditimit të fokusohet më shumë në proceset e vitit aktual në departamentet ku vlerësohet që reziuku është më i lartë, të kërkojë që cilësia e auditimit të përmirësohet dhe nga departamentet të kërkojë që rekomandimet e auditimit të trajtohen në pajtim me procedurat standarde të operimit të aprovuara nga Ministri i Financave.	Auditimi i brendshëm ka marrë parasysh vitin aktual të auditimit dhe janë bazuar në vlerësimin e rrezikut të auditimit.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Fitim Haliti, Udhëheqës i ekipit



Hysen Boqolli, Anëtar i ekipit



Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komentit i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Bazuar në testet e kryera rezultojnë se, kishte raste të klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim: - Shpenzimet për projektin "Ndërtimi dhe furnizimi me material ndërtimor për familjet skamnor", në shumën 37,163€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve; - Shpenzimet për projektin "Ndërtimi i serave me participim", në shumën 100,000€, 41,727€; dhe 34,020€ përkatësisht, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të regjistrohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve; dhe - Shpenzimet në emër të bashkëfinancimit në bujqësi me fermerët e Komunës, në shumën 40,000€, ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale në vend që të klasifikohen në	Mospajtimet tona janë paraqitur edhe në komentet të cilat i kemi dërguar në ZKA. E përsërisim thelbin e mospajtimin tonë të Çështja A1, konkretisht të OPINIONI I KUALIFIKUAR I PASQYRAVE FINANCIARE për vitin 2021. *Ne bazohemi në Ligjin e Buxhetit për vitin 2021, ku projektet e cilësuar si keqklasifikim nga ana e juaj, kanë qenë në listën e projekteve kapitale për vitin 2021, dmth. nuk kanë kaluar në pjesën e REZERVËS (i janë nënstruar Udhëzimit Administrativ 04/2019). *Nëse i përmbahemi Rregullores Financiare me nr. 02/2013, përkatsisht Nenit 2, pika 2.2 dhe pika 3.2, atëherë projektet kapitale që ju po konsideroni se janë të keqklasifikuara, kur dihet fakti se ne si organizatë buxhetore kemi krijuar kontrata me çdo fermer përfitues në afat prej 3-5 vjet (nuk është tjetërsuar pajisja, serra etj. brenda periudhë 3-5 vjeçare), pra llogaritet se janë ende pronë apo pasuri e komunës. Prandaj, duke u bazuar në nenet e cekura më lartë dhe mënyrën e trajtimit të pasurisë ose pronës si asete të komunës për periudhën e lartcekur, atëherë ne konsiderojmë se këto projekte kanë karakter të investimit kapital.	Bazuar në Udhëzimin administrativ MF-nr. 04/2019 për definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale, përkufizimi i projektit kapital është: një investim afatgjatë që përdoret për të ndërtuar, rritur ose përmirësuar asetet; ndërsa përkufizimi i Asetit: një resurs me vlerë ekonomike në pronësi të organizatës buxhetore, që rritë vlerën e pasurisë dhe që pritet të ofrojë përfitime në të ardhmen. Ndërsa, bazuar në Rregulloren MF – nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përkufizimi i pasurisë kapitale përveç tjerave definon se: pronësia dhe kontrolli i përfitimeve nga pasuria kapitale, mbetet te organizata buxhetore. Mbështetur në përkufizimet e përmendur më sipër, shpenzimet për projektet e listura në Çështjen A1: "Ndërtimi dhe furnizimi me material ndërtimor për familjet skamnor"; "Ndërtimi i serave me participim"; dhe "Bashkëfinancimi në bujqësi me fermerët", nuk janë projekte kapitale sepse kontrolli i përfitimeve nga pasuria kapitale nuk mbetet tek organizata buxhetore, andaj sipas nenit 18, paragrafi 3 i Rregullores Financiare nr 01/2013/ MF, Mbi shpenzimet e parasë publike", duhet të kenë kodet ekonomike adekuate sipas Udhëzimit Administrativ për planin kontabël.

kategorinë subvencioneve dhe transfereve.		
---	--	--

Leter konfirmi



 REPUBLIKA E KOSOVES
 REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E RAHOVECI - OPŠTINA GRAHOVAC
 Drejtoria për Administratë të përgjithshme
 Odojenje za Opštu upravu
 Nr i prot. 2042 / 06.06.2022
 Ur prot. RAHOVEC - GRAHOVAC

Komuna e Rahovecit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, si dhe:

Mospajtim të Çështja A1 (shih tabelën e bashkëngjitur dhe komentet e OB Rahevec).

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Smajl Latifi *Latifi*
 Kryetar i Komunës,
 Data: 9 qershor .2022

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Furnizimi me gypa PVC me vlerë 654€; Kanali i kullimit të tokave bujqësore me vlerë 48,636€; Investimet në këndin e lojrave me vlerë 6,810€; dhe Ndërtimi i qerdhes në Xërxë me vlerë 16,123€.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.